



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 401/1 prot.

Tiranë, më 24.04.2019

**VENDIM**  
**Nr.40, datë 24.04.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT**  
**TË ZBATIMIT TË VENDIMITTË KOMISIONERIT NR. 78, DATË 17.09.2018, NË**  
**INSTITUCIONIN AUTORITETI I KONKURENCËS.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 78, datë 17.09.2018, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Autoritetin e Konkurrencës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”,

**KONSTATOVA SE:**

Bazuar në Urdhrin nr. 28, datë 18.02.2019, të Komisionerit, “*Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë*”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 78, datë 17.09.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Autoriteti i Konkurrencës.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 03.01.2018, nëpërmjet Vendimit nr. 31, datë 16.04.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Autoriteti i Konkurrencës”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Autoriteti i Konkurrencës.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Autoritetit të Konkurrencës, raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr.78, datë 17.09.2018, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës si dhe një afat prej 30 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuara në këtë raport, si dhe në detyrat e lëna për institucionin e mbikëqyrur, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar në subjekt veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, konstatoj se situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit, konkretisht në pikën 2 të tij, është lënë detyrë, “Miratimi i planit vjetor të pranimi në shërbimin civil për vitin 2018”.

Konstatoj se me aktin nr. 248/5 prot., datë 26.09.2018, të Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës, është miratuar plani vjetor i pranimi në shërbimin civil për vitin 2018. Nga përmbajtja e këtij akti, vërej se janë pasqyruar nevojat për rekrutim të këtij institucioni, nga ku rezulton të jetë parashikuar plotësimi i 11 pozicioneve, të cilat, sipas kategorisë së pozicionit paraqiten si më poshtë:

- 1 pozicion i nivelit të mesëm drejtues;
- 10 pozicione të nivelit ekzekutiv (nga të cilat 9 pozicione me emërtesën “Inspektor” dhe 1 pozicion me emërtesën “Specialist”).

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues është lënë detyrë, për njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, sistemimi i dosjeve të personelit, duke i organizuar dhe plotësuar sipas përcaktimeve të nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të

*personelit*”, duke bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në aneksin nr. 3, pjesë e raportit përfundimtar.

Nga përmbajtja e aktit të konstatimit të mbajtur nga grupi i punës, vërej se:

- dosjet e personelit aktualisht janë në gjendje të mirë dhe administrohen nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse;
- janë plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara gjatë procesit tëmbikëqyrjes.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 78, datë 17.09.2018, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Autoritetin e Konkurrencës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Autoriteti i Konkurrencës, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr.78, datë 17.09.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**